

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE
“JUPITER ONLINE TRADE “ SHPK

Në bazë të Ligjit 9901 dtë 14.04.2008 ; për shoqërite Tregtare dhe Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, “ Për Qendren Kombetare të Rregjistrimit”, sot me datë **22.02.2022** une i nënshkruari:

Z. Gjelbrim HAJDARI, shtetas shqiptar, lindur më 04.06.1977, në Shtiqën, Kukës, banues në: Blv. Zogu i Pare, Pallati Alko-Impex, Kati 7, Ap. 56, Tirane, i indentifikuar me numër ID: **H70604041T**.

NENI 1

Formohet shoqëria tregëtare e Emertuar **“JUPITER ONLINE TRADE” SH.P.K**, me themelues **Z.Gjelbrim Hajdari**.

NENI 2

Shoqëria do të ketë statusin e nje shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesit të saj në kapitalin themeltar.

NENI 3

Veprimtaria e shoqërisë , marredhëniet e saj me persona të tretë juridikë e fizik, vendas dhe të huaj, shtetëror dhe privat rregullohen në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë për shoqëritë tregëtare si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore të dala në zbatim të këtij legjislacioni.

NENI 4

Shoqëria e ka selinë e saj në: **Tiranë, Rr. “Haxhi Dalliu” Nd. 6, H 13, 1057**, Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete te tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

NENI 5

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pa kufizuar.

NENI 6

Objekti i veprimtarisë së saj do të jetë :

Tregëtimi i produkteve online, transporti dhe lëvrimi i tyre në adresë, shpërndarja ose distribucioni i tyre online. Import-eksport, tregëti dhe shitje me shumicë e pakicë të një game të gjërë të produkteve si ato të ICT-së, smartphonëve, kancelerikeve, tonerave, dhuratave, librave, aksesoreve, lodrave, veshjeve, produkteve sportive, produkteve për bebe, biçikletave, pijeve, parfumeve dhe kozmetikeve, produkteve tekstile dhe të shëndetit, mallrave industriale dhe ushqimore, të gjitha llojeve te mjeteve motorike, motocikleta, autovetura, furgonë, kamione, si edhe pjesëve të tyre të këmbimit, etj. Veprimtari në fushën imobilare si shitje, blerje dhe dhënie me qira e pronave dhe e pasurive të paluajtshme. Transport i mallrave dhe pajisjeve për llogari të kompanisë dhe për të tretë, brenda dhe jashtë vendit. Ofrimin e shërbimeve të komunikimeve dhe njoftimeve publike elektronike, të ndërmjetësimit dhe lehtësimit të tregëtisë online, ofrimin e shërbimeve të ndryshme në fushën e burimeve njerëzore si, ndërmjetesim të tregut te punës dhe /ose fornimit profesional, si dhe vlerësimit të kërkesave dhe të aplikimeve për ndërmjetesimin për punë. Ofrimin e shërbimeve të marketingut dixhital, brandimit, optimizim SEO, fushatave Instagram Ads, Google Ads, Facebook Ads, etj. Shoqëria do të kryejë të gjitha aktivitetet e mësipërme, si edhe cdo aktivitet tjetër tregtar që nuk bie ndesh nga legjislacioni shqiptar në fuqi. Realizimin e shitjeve online nëpërmjet disa webportaleve: jupitershops.al, tonera.al, dhurate.al, librijuaj.al, aksesoret.al, lodrat.al, veshjet.al, sportivet.al, bebet.al, bicikletat.al, pijet.al, zanaciu.al, albanianfastcourier.al, realestatealbania.al, njoftimet.al, Etj.

NENI 7

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë i formuar nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë **Z. Gjelbrim Hajdari**.

Pjesëmarrja në kapitalin themeltar të shoqërisë është :

- **Z. Gjelbrim Hajdari 100.000 lekë**, përkatësisht 100% të kuotave.

Ky kapital ndahet në 1 (nje) kuote me vlere 100 leke qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

NENI 8

Veprimtaria e shoqërisë, emërtimi e selia e saj, të përcaktuara në këtë akt themelimi nuk mund të ndryshojnë pa pëlqimin e themeluesit të saj.

NENI 9

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit të Ortakut te Vetëm të shoqerise ,por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 10

Administrator i Shoqërisë "**JUPITER ONLINE TRADE** " Sh.p.k. është **Z. Gjelbrim Hajdari**, ai ka një mandat pesë vjeçar me të drejtë ripërteritje të këtij mandati. Fusha e veprimit, përberja dhe mënyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet me statut.

NENI 11

Ky akt u përpilua në katër kopje me fuqi të barabartë secila, për t'u depozituar në Qendren Kombëtare të Regjistrimit e per t'u shpërndare në organet kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin e Shoqërisë.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

"JUPITER ONLINE TRADE " Sh.p.k

GJELBRIM HAJDARI

GJELBRIM HAJDARI

